



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Seanca e jashtëzakonshme e Kuvendit
SJ-022
Prishtinë, më 7 mars 2018

PROCESVERBAL

**I SEANCËS SË JASHTËZAKONSHME TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS, E MBAJTUR MË 7 MARS 2018**

Seancën e kryesoi Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit, i ndihmuar nga Xhavit Haliti, nënkryetar i Kuvendit.

Kryetari i hapi punimet e seancës së jashtëzakonshme, sipas kërkesës së deputetëve të Kuvendit, Avdullah Hoti dhe Arbërie Nagavci, të mbështetur edhe nga 38 deputetë të tjerë nënshkrues.

Në fillim të seancës, kryetari i Kuvendi i uroi të gjithë mësimdhënësit me rastin e 7 Marsit, Ditës së Mësuesit.

Më pas, seanca i vazhdoi punimet me pikën e vetme të rendit të ditës:

1. Debat parlamentar lidhur me vendimin e Regjistrimit Evropian të Sigurimit të Cilësisë për Arsimin e Lartë (EQAR) për përjashtimin e Agjencisë Kosovare të Akreditimit

Kryetari i njoftoi deputetët se me kërkesën e deputetëve të Kuvendit, Avdullah Hoti dhe Arbërie Nagavci, të mbështetur edhe nga 38 deputetë të tjerë nënshkrues është kërkuar

seanca e jashtëzakonshme për debat parlamentar lidhur me vendimin e Regjistrit Evropian të Sigurimit të Cilësisë për Arsimin e Lartë (EQAR) për përjashtimin e Agjencisë Kosovare të Akreditimit.

Kryetari i Kuvendit e ftoi z. Avdullah Hoti që në emër të propozuesit ta paraqesë çështjen për të cilën është kërkuar debati parlamentar.

Kryetari i Grupit Parlamentar të LDK-së, Avdullah Hoti, tha se Agjencia Kosovare e Akreditimit (AKA) është autoritet i pavarur, e cila i akrediton dhe i riakrediton institucionet publike dhe private të arsimit. Nëpërmjet procesit të akreditimit, AKA e mbështet zhvillimin e cilësisë në institucionet e arsimit të lartë në Kosovë.

Ai tha se ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, z. Shyqiri Bytyqi, më 27.02.2018 ka pranuar Vendimin e Regjistrit Evropian të Sigurimit të Cilësisë për Arsimin e Lartë, me anë të të cilit Agjencia Kosovare e Akreditimit përjashtohet nga ky regjistër.

Vendimi i Regjistrit Evropian të Sigurimit të Cilësisë për Arsimin e Lartë për përjashtimin e Agjencisë Kosovare të Akreditimit është pasojë e vendimit të ministrit të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për shkarkimin e Bordit të Agjencisë Kosovare të Akreditimit.

Sipas vendimit të Regjistrit Evropian të Sigurimit të Cilësisë për Arsimin e Lartë, me shkarkimin e Bordit kjo agjenci e ka humbur aftësinë e saj për të vepruar në mënyrë autonome. Ligji për Arsimin e Lartë, neni 7, pika 5, thotë: “Nëse më shumë se një e treta e anëtarëve të Bordit zëvendësohen për çfarëdo arsye brenda një viti, Ministria duhet t’i raportojë Kuvendit”, gjë që nuk ka ndodhur.

Duke e pasur parasysh rëndësinë e kësaj çështjeje, si dhe pasojat të cilat prekin arsimin e lartë në Republikën e Kosovës nga përjashtimi i Agjencisë Kosovare të Akreditimit nga Regjistri Evropian i Sigurimit të Cilësisë për Arsimin e Lartë, deputetët, Kuvendi dhe qytetarë duhet të informohen lidhur me këtë çështje.

Diskutimi i plotë i z. Avdullah Hoti është dhënë në transkript.

Në vazhdim nënkryetari i Kuvendit, Xhavit Haliti, e ftoi edhe znj. Arbërie Nagavci që në emër të bashkëpropozuesit ta paraqesë dhe ta arsyetojë kërkesën për debat parlamentar.

Deputetja Arbërie Nagavci, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje” theksoi se kjo seancë e jashtëzakonshme e thirrur sot po vjen si reagim pas një situatë të krijuar, e cila është rezultat i ndikimit të drejtpërdrejtë të politikës, gjegjësisht grupeve partiake dhe biznese në sistemin e arsimit të lartë.

Ajo tha se situata e krijuar në arsimin e lartë së fundmi, por edhe në sistemin e arsimit në përgjithësi në vendin tonë, nuk paraqet asgjë të re e të papritur. Ndaj dhe nuk duhet të na

befasojë vendimi i Regjistrit Evropian të Sigurimit të Cilësisë për Arsimin e Lartë për përjashtimin e Agjencisë Kosovare të Akreditimit nga ky regjistër.

Vendimi për të përjashtuar Agjencinë Kosovare të Akreditimit nga Regjistri Evropian i Sigurimit të Cilësisë për Arsimin e Lartë do të ketë pasoja të mëdha dhe të rënda për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës.

Kuvendi dhe të gjitha palët e interesuara duhet të njoftohen pse janë shkarkuar menjëherë të nëntë anëtarët e Bordit të Agjencisë së Kosovës për Akreditim, në mesin e të cilëve kishte edhe anëtarë ndërkombëtarë, ekspertë të arsimit të lartë, që vlerësohen nga komuniteti akademik ndërkombëtar.

Të tërhiqet pika e planifikuar për seancën plenare për ratifikimin e anëtarëve të Këshillit Shtetëror të Cilësisë dhe e njëjta të silltet në rend të ditës pas marrjes së të gjitha masave që e garantojnë një proces krejtësisht të besueshëm profesional, konstruktiv e me transparencë të plotë, që reflekton me propozimin e anëtarëve të rinj të Këshillit Shtetëror të Cilësisë që kanë kredibilitet profesional e moral, të paanshëm politik, të liruar nga konflikti i interesit dhe me integritet personal. Diskutimi i plotë i znj. Arbërie Nagavci është dhënë në transkript.

Më pastaj, kryesuesi fjalën ia dha ministrit të Arsimit, z. Shyqiri Bytyqi.

Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, z. Shyqiri Bytyqi, theksoi se sot kemi për diskutim vetëm një segment të sistemit arsimor, siç është Agjencia Kosovare për Akreditim, si pasojë e largimit të kësaj agjencie nga Regjistri Evropian i Sigurimit të Cilësisë për Arsimin e Lartë, EQAR. EQAR kërkon standarde, rregulla dhe cilësi në arsimin e lartë.

Ai tha se Ministrinë e Arsimit e gjetëm me shumë probleme funksionale, të grumbulluara për vite të tëra. E sapo e konstatuam këtë gjendje, edhe nga Zyra e Unionit Evropian në Kosovë nëpërmjet raportit të vlerësimit të dorëzuar në fund të muajit të kaluar, për të cilin vlerësim ne ishim dakorduar me qëllim që në fillimin e marrjes së detyrës sonë t'i dimë ku janë mangësitë e kësaj ministrie, në mënyrë që hapat tanë të jenë të sigurt drejt përmirësimit të kësaj gjendjeje.

Vendimi për shkarkimin e Këshillit Shtetëror të Cilësisë me kërkesën e kryeministrit, i cili erdhi në fillim të mandatit tonë, jo më shumë se në dhjetëditëshin e parë të detyrës, mbase tani nga kjo perspektivë e ngjarjeve mund të quhet veprim i ngutshëm, por besoj se gjatë këtij debati do të kemi mundësi t'i shpalosim parregullsitë e mëdha që e kanë karakterizuar këtë agjenci, e që në një të ardhme jo të largët do të kishte përfunduar po kështu siç përfundoi sot, me përjashtim nga EQAR.

Për ta treguar vendosmërinë e ministrisë së Agjencia Kosovare e Akreditimit nëpërmjet Këshillit Shtetëror të Cilësisë duhet të funksionojë e pavarur dhe pa rezervat që u shprehën, edhe pse me vonesë për mospajtim me këtë listë, ne i kemi drejtuar një kërkesë kryeministrit për ta pezulluar këtë listë dhe për të hapur mundësi të verifikimit të kësaj liste. Për një verifikim të tillë kemi kërkuar mbështetjen edhe të Unionit Evropian në Kosovë dhe çdo pale të interesuar, përfshirë edhe Parlamentin.

Diskutimi i plotë i z. Shyqiri Bytyqi është dhënë në transkript.

Në vazhdim, kryesuesi e hapi debatin lidhur me vendimin e Regjistrisë Evropiane të Sigurimit të Cilësisë për Arsimin e Lartë (EQAR) për përjashtimin e Agjencisë Kosovare të Akreditimit.

Lidhur me çështjen e ngritur për këtë debat parlamentar diskutuan deputetët: Ismaj Kurteshi, në emër të GP të LVV-së; Valentina Bunjaku-Rexhepi, në emër të GP të LDK-së; Nezir Çoçaj, në emër të GP të PDK-së; Teuta Haxhiu, në emër të GP të AAK-së; Albulena Balaj-Halimaj, në emër të GP të “Nisma për Kosovën”; Albert Kinolli, në emër të GP “6+”; Arbër Rexhaj, Naser Rugova, Drita Millaku, Bekim Haxhiu, Bekë Berisha, Milaim Zeka, Glauk Konjufca, Lumir Abdixhiku, Mirjeta Kalludra, Memli Krasniqi, Bilall Sherifi, Emilija Redžepi, Fitore Pacolli, Mimoza Kusari-Lila, Salih Salihu, Armend Zemaj, Arbërie Nagavci, Nezir Çoçaj, Teuta Haxhiu, Enver Hoti, Fidan Rekalii, Imet Rrahmani, Ilir Deda, Korab Sejdiu, kryeministri Ramush Haradinaj, zëvendëskryeministri Fatmir Limaj dhe ministri Shyqiri Bytyqi, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesuesi e ftoi deputetin Avdullah Hoti t’i paraqesë rekomandimet lidhur me vendimin e Regjistrisë Evropiane të Sigurimit të Cilësisë për Arsimin e Lartë (EQAR) për përjashtimin e Agjencisë Kosovare të Akreditimit.

Kryetari i Grupit Parlamentar të LDK-së, Avdullah Hoti, i paraqiti rekomandimet e harmonizuara edhe me grupet e tjera parlamentare.

Kryesuesi i hodhi në votim rekomandimet e propozuara.

Rezultati i votimit ishte si në vijim:

Për ----- 61,
Kundër -----1,
Abstenime -----0.

Kuvendi me shumicë votash nxori këto:

REKOMANDIME

1. Brenda afatit të ankimimit të ndërmerren të gjitha veprimet e duhura për të kthyer AKA-në si anëtare të rregullt në EQAR.
2. Ministri të raportojë në Kuvend për:
 - a. Arsyet e shkarkimit të Bordit, duke ofruar informata për Komisionin Funkcional (në raportim me dyer të mbyllura, nëse është e nevojshme),
 - b. Për veprimet që janë ndërmarrë ndaj ish-anëtarëve të Bordit për shkeljet e pretenduara që mund t'i kenë bërë ata.
3. Ministri ta tërheqë nga Kuvendi për verifikim propozim-vendimin për anëtarë të Bordit.
4. Në afatin prej shtatë (7) ditësh, një ekip pune, i përbërë nga të gjitha palët (ekspertë të arsimit, përfaqësues të Ministrisë, përfaqësues të organizatave që monitorojnë punën e arsimit të lartë dhe të tjerë) të përgatisë Udhëzimin Administrativ që miratohet nga ministri, i cili do t'i përcaktojë kriteret dhe procedurat transparente për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit.
5. Bazuar në këtë Udhëzim Administrativ, lista e anëtarëve të Bordit të procedohet në Kuvend për miratim.
6. Kuvendi obligohet që brenda dhjetë (10) ditësh, nga dita e dorëzimit të propozim-vendimit nga Qeveria, ta radhisë në rend dite të seancës plenare për miratim.
7. Kuvendi i rekomandon ministrit të fillojë hartimin e një propozim-ligji të ri për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë, i cili siguron autonominë e Agjencisë.

Kryesuesi i mbylli punimet e seancës së jashtëzakonshme më 7 mars 2018, në orën 18:30.

Kryetari i Kuvendit:

Kadri Veseli

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale